



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.412/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, paraqitur kundër Ndërmarrjes publike “Pallati i Rinisë dhe Sporteve”, me seli në Komunën e Prishtinës, për shkak të refuzimit të kërkesës për shfrytëzimin e sallës së sporteve, për mbajtjen e aktivitetit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, raundi i dytë për Kryetar të Komunës, që do të mbahet me 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 07.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR ankesa ZL.Anr.412/2025 datë 06.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në komunën e Prishtinës, kundër Ndërmarrjes publike “Pallati i Rinisë dhe Sporteve”, me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkesës për shfrytëzimin e sallës së sporteve, për mbajtjen e aktivitetit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, raundi i dytë për Kryetar të Komunës, që do të mbahet me 09 Nëntor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.412/2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën thekson se me datë 31.10.2025, Ndërmarrja Publike “Pallati i Rinisë dhe i Sporteve”, përmes zyrtares përgjegjëse znj. Albrie Kastrati ka refuzuar kërkesën e subjektit tonë për përdorimin e sallës sportive me 08.11.2025 në orën 20:00, duke e arsyetuar këtë refuzim me pretendimin se "salla ka aktivitet tërë ditor". Ky pretendim rezulton të jetë i pavërtetë, pasi Federata e Xhudos së Kosovës dhe Klubi i Xhudos "Polici", përmes një emaili zyrtar, kanë konfirmuar se aktiviteti i tyre përfundon në orën 16:00, pra katër orë përpara kohës së kërkuar nga ne për mbajtjen e aktivitetit. Kjo do të thotë se nuk ekziston asnjë pengesë faktike apo logjistike për zhvillimin e aktivitetit të planifikuar. Refuzimi i tillë është bërë pavarësisht faktit se Lëvizja VETËVENDOSJE! ka miratimin zyrtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për mbajtjen e tubimit në orën 20:00. Si rrjedhojë, ky veprim përbën shkelje të drejtpërdrejtë të

nenit 4, paragrafit 2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, sipas së cilit subjektet politike të certifikuara kanë të drejtë të mbajnë tubime në hapësira publike, përfshirë institucionet sportive dhe kulturore, për sa kohë që nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe është dhënë miratimi nga institucioni përkatës dhe KKZ-ja. Në këtë rast, meqë puna e rregullt e sallës sportive përfundon në orën 16:00, dhe KKZ-ja ka dhënë miratimin për përdorim në orën 20:00, refuzimi i bërë nga Pallati i Rinisë dhe Sporteve është i pajustificuar dhe bie ndesh me parimin e barazisë së subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore. Për më tepër, nga rrethanat objektive dhe provat e paraqitura, vërtetohet qartë se mbajtja e aktivitetit në këtë sallë në orën 20:00 nuk do të shkaktonte asnjë pengesë për asnjë palë tjetër, për faktin se aktiviteti i Federatës së Xhudos përfundon në orën 16:00, ndërsa edhe Radio Televizioni i Kosovës (RTK), që do të zhvillojë aktivitet në të njëjtën ditë, ka konfirmuar se kërkesat e partive politike nuk përplasen për aq sa nuk janë të planifikuara mes orës 21:00 dhe 23:00, çka nënkupton se orari i kërkuar nga ne (20:00) është plotësisht i përshtatshëm dhe i lirë.

Me vendimin ZL.Anr.367/2025 të datës 05.11.2025 PZAP, ka refuzuar kërkesën tonë, por kjo ka ndodhur para daljes së provave të reja, përkatësisht, komunikimin e Federatës së Xhudos lidhur me përfundimin e aktivitetit të tyre deri në orën 16:00. Për këtë arsye, kërkojmë që PZAP të ndërhyjë me vendim të menjëhershëm për të garantuar ushtrimin e së drejtës sonë ligjore për të mbajtur tubimin në hapësirat dhe kohën e miratuar nga KKZ-ja, duke na mundësuar zhvillimin e aktivitetit elektoral pa pengesa artificiale dhe në përputhje me parimin e barazisë dhe drejtësisë zgjedhore. Si provë ka bashkangjitur: miratimi i KKZ-së për mbajtjen e aktivitetit, emaili zyrtar i Federatës së Xhudos së Kosovës që vërteton se aktiviteti i tyre përfundon në orën 16:00, Oraret e Turneut Ndërkombëtar në xhudo "Adem Jashari" emaili i menaxhmentit të RTK-së, si dhe korrespondenca me znj. Kastrati që dëshmon refuzimin e paarsyeshëm.

Në përgjigje në ankesë ndërmarrja Publike "Pallati i Rinisë dhe i Sporteve", me seli në Prishtinë, përmes zyrtares përgjegjëse znj. Albrie Kastrati, përmes email-it të datës 04.11.2025, ka deklaruar se me datë 8 nëntor janë anuluar edhe disa kërkesa të tjera, jo vetëm ajo e Lëvizjes Vetëvendosje. Arsyeja e anulimit të këtyre kërkesave është se në atë datë zhvillohet një aktivitet ndërkombëtar në xhudo, i cili është gjithëditor. Me organizatorin e aktivitetit jemi koordinuar në këtë menyre që në fillim të rezervimit të datës 8 nëntor, andaj në bazë të rregullores se brendeshme nuk lejohen të zhvillohen dy aktivitete në të njëjten kohë. Tutje, ka bashkangjitur dhe email-in me stafin i klubit Xhudos "Policë", të cilët kanë konfirmuar përdorimin e palestrës për tërë ditën e shtunë me 08.11.2025.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se nga informacioni që kemi pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës, subjekti politik LVV me datën 17.10.2025, ka dorëzuar formularin për njoftimin e tubimit politik për tubimin e datës 08 nëntor 2025, sipas kërkesave ligjore, ku edhe i ka bashkangjitur përgjigjes formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit politik të miratuar nga KKZ Prishtinë, si dhe emailin e datës 28.10.2025 të datës nga ana e LVV-së, përmes të cilit, është njoftuar për orën e saktë të zhvillimit të tubimit me 08.11.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- **Ankesa është e palejuar.**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën ZL.Anr.367/2025, të paraqitur me datën 03.11.2025, dhe provat shtesë të datës 05.11.2025, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.367/2025, të datës 05.11.2025.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.367/2025 të datës 05.11.2025 dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli e hedhi ankesën si të palejuar.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 par.3.5 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLAnr.412/2025 datë 07.11.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.